

ADVANCE LACK



PËRSHKRIMI

Bojë për metale dhe dru me veti shumë të mira mbuluese dhe shkëlqim shumë të lartë

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Nivel shkëlqimi të lartë
- Gjendet në 14 ngjyra
- Mbulueshmëri e shkëlqyer
- Punueshmëri dhe nivelim shumë të mirë
- Ngjyra brilante të qëndrueshme për një kohë të gjatë
- Rezistencë ndaj kushteve atmosferike

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Rekomandohet të përdoret mbi të gjitha sipërfaqet metalike dhe drusore që janë të destinuara për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Përdoret për lyerjen e konstruksioneve metalike që janë të destinuara për përdorim në ambiente industriale si për shembull kapanone, ura, shkallë, kangjella, dyer metalike, etj. Përdoret për lyerjen e gardheve të bëra me ristela druri, shkallëve prej druri, parmakëve prej druri, etj.

PERGATITJA E PRODUKTIT

Bëni hollimin e produktit duke përdorur solventin e duhur deri në viskozitetin e përshtatshëm për aplikim. Rekomandohet që përzierja e produktit me solvent të bëhet duke përdorur një mikser elektrik.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqet nga boja e vjetër e dëmtuar, e pa ngjitur dhe pjesët e ndryshkura duke bërë zmerilimin e sipërfaqes. Me anën e procesit të larjes eliminoni të gjithë pluhurat e krijuara nga procesi i zmerilimit si dhe elemente të tjera që pengojnë ngjitjen si graso, vajra, etj. Më pas bëhet aplikimi i astarit MetalGrund 410 ose MetalhaftGrund 550. Pas tharjes së plotë të astarit bëhet aplikimi i produktit Advance Lack. Sipërfaqet e drurit dhe metalit duhet të jenë pa përmbajtje të lartë lagështie, të pastra nga pluhurat dhe pa elemente që pengojnë ngjitshmërinë e bojës.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Rezinë alkide
Densiteti EN ISO 2811-1	Komp. A $1,20 \pm 0,02$ gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	72%
Shkalla e hollimit	10 – 20%
Viskoziteti	90 ± 5 KU
Koha e tharjes	3 - 4 orë Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur
VOC në produktin e gatshëm (Direktiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 100
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 20

APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit Advance Lack bëhet me anën e një pistolette me ajër, me furçë ose me rrul. Fillimisht hidhni produktin e përgatitur në enën mbajtëse. Më pas me anën e pistoletës bëhet hapja e produktit mbi sipërfaqen e metalit. Aplikimi bëhet duke aplikuar dy shtresa të njëpasnjëshme në mënyrë që të bëhet mbulimi sa më i mirë i sipërfaqes së drurit ose metalit. Sigurohuni që të përftohet spessori i duhur i shtresës në mënyrë që të arrihet mbrojtja maksimale. Pastroni mjetet e punës menjëherë pas përdorimit duke përdorur pastrues me bazë solventi.

PAKETIMI

Kanace 0.75lt

RUAJTJA

36 muaj, me kusht që kanaçet të jenë të mbyllura dhe në kushte normale ruajtjeje.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që të shmangët aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C

